



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 21.1.7-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR PËR PROJEKTIN "PËRKRAHJE PËR
PËRMIRËSIMIN E HARTIMIT (ZHVILLIMIT) TË POLITIKAVE NË
KOSOVË"**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016

Auditim në bazë të marrëveshjes me SIDA-në

Prishtinë, maj 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Raportin Financiar Vjetor për Projektin “Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit (Zhvillimit) të Politikave në Kosovë”, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha (Udhëheqës Ekipi) dhe Refiqe Morina (Anëtare), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Raportimi financiar dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
Hyrje.....	6
1.1 Opinioni i auditimit	6
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim financiar dhe kërkesat tjera për raportim	7
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	8
Hyrje.....	8
2.1 Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin.....	8
2.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.....	8
2.2.1 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale.....	9
2.3 Obligimet e papaguara	10
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	11
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	12

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar për Projektin “Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit (Zhvillimit) të Politikave në Kosovë” për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm.

Fondi për përmirësimin e zhvillimit të politikave në Kosovë është krijuar në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës (përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit), përmes Sekretariatit Koordinues të Qeverisë dhe përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar. Projekti ka tre synime kryesore në drejtim të përmirësimit të performancës së zyrave të Zyrës së Kryeministrit në kornizën aktuale të detyrave:

- krijimi i bazave të qarta mbi të cilat mund të ndërtohen procedurat e zhvillimit të politikave në Kosovë;
- ngritja e kapaciteteve dhe zgjerimi i kornizave të shkathtësive të stafit kyç për zhvillimin dhe koordinimin e politikave; dhe
- përmes Zyrës së Kryeministrit, ngritja e kapaciteteve të ministrive të linjës në pajtim me detyrat që stafi i këtyre ministrive duhet të përmbushë. Objektiva pasqyron prioritetet e Qeverisë së Kosovës për reformën në Administratën publike, si shumë të rëndësishme për menaxhimin dhe zhvillimin ekonomik dhe avancimin në procesin e integritit në Bashkimin Evropian.

Ekzaminimi i raportit financiar për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin financiar.



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit.

Përgjigja e Sekretarit të Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Raporti Vjetor Financiar *paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

1 Raportimi financiar dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Raportimit financiar të projektit të financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në raport. Po ashtu ne kemi konsideruar edhe krahasimin e realizimit të shpenzimeve në raport me planifikimin e aktiviteteve të projektit.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar Raportin Financiar të projektit të financuar nga SIDA "Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit (Zhvillimit) të Politikave në Kosovë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 i cili përfshinë, një përmbledhje të Krahasimit të Buxhetit me Shumat Aktuale dhe Shënimet shpjeguese.

Sipas opinionit tonë Raporti Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezanton një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për raportim financiar

Menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit (ZKM), është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të raportit financiar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e raportit financiar, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e raportit financiar

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për raportin financiar në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se raporti financiar nuk përmban keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në raportin financiar. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në raportin financiar, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e raportit financiar nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të raportit financiar.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim financiar dhe kërkesat tjera për raportim

ZKM-ja kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit (ZKM), përmes Sekretariatit Koordinues të Qeverisë (SKQ), si dhe Suedisë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA);
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194; dhe
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 për shpenzimin i parave publike.

Në kontekst të raportimit, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Në lidhje me fondet e shpenzuara nga ZKM-ja është përgatitur raporti përmbledhës, derisa ky raport më tej do të përfshihet në Pasqyrat Financiare Vjetore të "Konsoliduara" të ZKM-së. Raportimi financiar është bërë në përputhje me marrëveshjen, po ashtu është përgatitur raporti narrativ i cili përmban një analizë mbi progresin e aktiviteteve të projektit dhe rezultatet.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, procesin e pagesave dhe detyrimet.

2.1 Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Sistemet dhe transaksionet financiare janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, me përjashtim të disa mangësive të vogla sa i përket realizimit të buxhetit, regjistrimit të shpenzimeve në nën kode ekonomike adekuate dhe vonesave në pagesën e obligimeve.

2.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Te gjitha shpenzimet e realizuara në kuadër të projektit i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime. Në tabelën në vijim, ne i kemi shqyrtuar shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Tabela 1 . Shpenzimet e realizuara në raport me buxhetin (në €)

Përshkrimi	Buxheti 2016	Realizimi 2016	Buxheti i pashpenzuar
Konferencat	15,000	1,510	13,490
Pagat për praktikantët	10,000	9,970	30
Pajisjet e zyrës	10,000	6,276	3,724
Përkthimi dhe të tjera	10,000	4,303	5,697
Sallat e takimeve	30,000	30,752	-752
Seminarët me vendet partner	20,000	19,882	118
Gjithsej	95,000	72,692	22,308

Çështja 1 - Realizimi i buxhetit – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit gjatë vitit 2016 ishte në nivel të ulët, vetëm 77% e buxhetit final ishte realizuar. Vonesa në fillimin e realizimit të projektit ka reflektuar në realizimin e ulët të buxhetit.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i aktiviteteve financiare dhe realizimit i ulët i buxhetit e redukton efektivitetin e planit vjetor operativ dhe vështirëson arritjen e objektivave të synuara të projektit.
- Rekomandimi 1** Sekretari i Përgjithshëm në koordinim më SKQ-në duhet të ndërmarrin një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në 2017.

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 95,000€. Prej tyre ishin shpenzuar 72,692€, ose 77%. Kontrollat në fushën e shpenzimeve kanë funksionuar mirë, megjithatë nevojiten veprime shtesë për adresimin e mangësive në vijim.

Çështja 2 - Regjistrimi i shpenzimeve në nën kode ekonomike jo adekuate – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Shpenzimet për mëditje të udhëtimit në vlerë 8,996€ nuk janë regjistruar në kodet adekuate. Kodi adekuat për regjistrimin e tyre ishte 13141 - për mëditje të udhëtimit zyrtar, ndërsa ato janë regjistruar gabimisht në kodin 13140 - si shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar. Megjithatë, në raportin financiar janë prezantuar drejtë si mëditje të udhëtimit zyrtar.
- Rreziku** Klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate redukton transparencën dhe ndikon në prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve.
- Rekomandimi 2** Sekretari i Përgjithshëm në koordinim më SKQ-në duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprime shtesë në mënyrë që regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në kodet ekonomike përkatëse.

2.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 7,741€. Faturat/obligimet e papaguara kryesisht ishin pasojë e kontrolleve jo të mira në procesin e pagesave nga Zyra e Kryeministrit.

Çështja 3 - Vonesa në pagesën e faturave /obligimeve - Prioriteti mesëm

- E gjetura** Sipas nenit 39 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Organizata buxhetore, çdo faturë të vlefshme duhet ta paguaj brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimin të faturës. Gjatë testeve tona kemi vërejtur që në 15 raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë 7,741€ nuk janë paguar brenda afatit kohor ligjor.
- Rreziku** Mos pagesa e obligimeve brenda afatit kohor ligjor mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve për shkak të ndëshkimeve me kamata nga furnitorët si dhe rritjen e obligimeve të papaguara në fund të vitit.
- Rekomandimi 3** Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me SKQ-në duhet të sigurojnë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor në mënyrë që të shmanget ekzekutimi i pagesave drejtpërdrejtë nga thesari, apo rritja e obligimeve të papaguara në fund të vitit.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë në Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Sekretari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.